



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV
Sesioni pranveror

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike
Mbledhja nr. 5
Prishtinë, më 06 Mars 2013, në orën 13:00, sala N-303
Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR MBIKËQYRJEN E FINANCEVE PUBLIKE

Në mbledhje morën pjesë: Ali Sadriu, Mursel Haljilji, Valbona Dibra, Ramiz Lladrovci, Imri Ahmeti, Adem Grabovci, Bali Muharremaj dhe Afrim Hoti.

Mungoi: Albert Kinolli.

Të ftuar: Besim Beqaj, ministër-Ministria e Zhvillimit Ekonomik dhe Lars Lage Olofsson - auditor i përgjithshëm.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Fatime Qorri, koordinatore, Mehmet Simnica, zyrtar i fushës për ekonomi dhe Saranda Kelmendi, praktikante.

Mbledhjen e kryesoi: Ali Sadriu, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

1. **Miratimi i rendit të ditës;**
2. **Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Komisionit, të mbajtur më 27.02.2013;**
3. **Shqyrtimi i Raportit për Performancën e Ndërmarrjeve Publike për vitin 2011;**
4. **Të ndryshme.**

***Kryesuesi** konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.*

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, njëzëri, miratoi rendin e ditës pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Komisionit, të mbajtur më 27.02.2013

Kryetari- Konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike e miratoi, njëzëri, pa vërejtje, procesverbalin e mbledhjes së Komisionit, të mbajtur më 27.02.2013.

3. Shqyrtimi i Raportit për Performancën e Ndërmarrjeve Publike për vitin 2011

Kryetari – Koha për shqyrtimin e këtij raporti është shumë vonë. Në Kuvend ky raport është dorëzuar me vonesë edhe atë në fund të vitit 2012. Raporti nuk përmban të dhëna individuale për performancën e secilës ndërmarrje publike. Raporti nuk përmban një plan veprimi për rekomandimet e viteve paraprake. Të gjitha ndërmarrjet publike, në përjashtim të Postës, Aeroportit, KEK-ut dhe KOSTT-it, janë duke operuar me humbje. Mirëpo edhe për ndërmarrjet që kanë operuar me një bilanc pozitiv, fitimet e tyre janë zvogëluar krahasuar me vitin 2010. ZAP ka dhënë shumë rekomandime për adresim të çështjeve. Është për t'u befasuar kur MZHE-ja nuk ka mbajtur mbledhjen vjetore të aksionarëve. Qeveria duhet të nxjerrë politika dhe të monitorojë ato politika. MZHE akoma nuk ka hartuar platformë për adresim të këtyre të gjeturave. 4 kompani nuk kanë borde, sipas raporteve të ZAP-it. Në shumë borde janë emëruar njerëzit joprofesional dhe si rezultat i kësaj performanca nuk është ajo e pritshmja. E hap diskutimin.

Ramiz Lladrovci – Personalisht nuk është shumë i kënaqur me Raportin e performancës së Ndërmarrjeve Publike. Bordet e Ndërmarrjeve Publike kanë mundur të jenë menaxhues më të mirë. MZHE - ka përkrahjen e Komisionit për të ndërhyrë në kompanitë e ujërave për përmirësim të punës.

Lidhur me planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të ZAP-it për vitin 2012, nuk jam i kënaqur me veprimin e paraparë nga ministria. Është fjala për rekomandimin 9 – ku MZHE ka paraparë veprimin për adresim *“në kohën sa më të shpejtë të mundshme”*. Koha duhet të precizohet saktë se kur do të adresohet kjo e gjetur. Inkurajoj ministrin që edhe pse nuk ka një ndikim të drejtpërdrejtë në punën e tyre, megjithatë ka të drejtën nga Komisioni për ndërmarrjen e masave, në ato kompani ku nuk ka funksionuar bordi.

Valbona Dibra- Raporti për performancën e ndërmarrjeve publike qendrore për vitin 2011, pasqyron të dhëna reale për gjendjen e ndërmarrjeve publike. Në këtë raport është pasqyruar puna njëvjeçare e 17 ndërmarrjeve publike qendrore, pra aktivitete për vitin 2011. Edhe pse pjesa hyrëse ose përmbledhëse e këtij raporti është pak e mangët dhe në shikimin e parë të lë përshtypjen e një raporti jo mirë të përgatitur, në brendinë e tij jap informata të mjaftueshme për performancë të ndërmarrjeve publike. Shpresoj që këtë vit do të pranojmë raport edhe më mirë të përgatitur.

Disa nga të arriturat e ndërmarrjeve publike janë: Në f. 17 – raportet tremujore dhe vjetore – gjatë vitit 2011, të gjitha NP i kanë dorëzuar këto raporte, po ashtu të gjitha ndërmarrjet publike kanë përgatit planin e biznesit për vitin 2012, ashtu siç janë të obliguara me ligj. Të të gjitha ndërmarrjet publike ka përfunduar auditimi i jashtëm për vitin 2011, ku kanë rezultuar 10 raporte me opinion të pakualifikuar, 6 raporte me opinion të pakualifikuar me theksim të çështjes dhe një i kualifikuar. Nga kjo shihet se, krahasuar me vitin paraprak, ka pasur një progres të theksuar në dhënien e opinioneve nga auditorët e jashtëm. Të gjitha ndërmarrjet publike kanë auditor të brendshëm.

Në faqen 21 shihet se Qeveria ka bërë reduktimin e subvencioneve për 26.5 %, në krahasim me vitin paraprak. Në faqen 22, në tabelën 3 vërehet që ka progres në krahasim me vitin paraprak, si rezultati i rritjes së të hyrave, ka fitim të përgjithshëm vjetor për 11.8 %. Po ashtu, progres ka edhe te prodhimi i ujit për 4.5 %, në krahasim me vitin 2010, si dhe inkasimi është rritur 3%, (f. 24).

Në faqen 29, shihet performanca financiare e KEK-ut – ku të hyrat kanë rritje 7.7 % në krahasim me vitin paraprak dhe fitimi vjetor ka pasur rritje prej 16.7 %. Në faqen 51 shihet që Train - Kos, ka arritur fitim financiar prej 348 mijë euro, që është rezultat i të hyrave prej 2.3 milionë euro.

Disa nga sfidat janë: Në faqen 70 shihet se sfida për kompaninë KUR Hidrodrini është humbja e ujit. Fatmirësisht kjo humbje është me ritëm të ngadalshëm dhe pritet të evitohet pas investimeve nga investitorët e jashtëm.

Si sfidë është edhe përmirësimi i kualitetit të ujit të pijes në regionin e Vushtrrisë dhe Skenderajt, ku krahasuar me vitin 2010 lë vend për përmirësim, (faqe 74).

Këto janë fakte që figurojnë në raport dhe mendoj se ne duhet të debatojmë rreth asaj çka shkruhet në raport dhe jo në atë se çfarë shkruajnë mediat.

Propozoi që Komisioni t'i rekomandojë Kuvendit, miratimin e këtij raporti. Të njëjtin rekomandim ka dhënë edhe Komisioni për zhvillim ekonomik, infrastrukturë, tregti dhe industri i cili është Komisioni Funkcional dhe mbikëqyrë punën e ndërmarrjeve publike.

Bali Muharremaj – Bazuar në raportet e ZAP-it Qeveria në 4 kompani të ujit për vitin 2011, nuk kishte zgjedhur Bordet dhe Komisionet e auditimit, në përputhje me kërkesat e Ligjit mbi Ndërmarrjet Publike. Cilat ishin pengesat për mos kompletimin e anëtarëve të bordeve për Ndërmarrjet Publike? Nga Ndërmarrjet Publike të audituara si: Kompanitë e Ujit, Kompanitë e Hedhurinave, të hyrat e KEK-ut etj. Vërehet se nuk janë duke performuar mirë, kjo thuhet edhe sipas raporteve të hartuara nga vetë ZAP-i. Çka ka ndërmarr Ministria e Zhvillimit Ekonomik në përmirësimin e kësaj performance të vlerësuar dobët në cilësi të aksionarit? Sipas ZAP-it thuhet se MZHE ka hartuar një plan veprimi për adresimin e rekomandimeve për kompanitë e ujit, të cilin plan ka dorëzuar edhe në ZAP, mirëpo ende nuk dihet se sa janë adresuar këto rekomandime. Deri ku është arritur në adresimin e çështjeve të theksuara nga ZAP-i?

Afrim Hoti - Raporti nga 90 faqe i hartuar nga NJPMNP, në përgjithësi përmban të dhëna për misionin dhe objektivat e ndërmarrjeve, por nuk përmban shumë të dhëna për performancën e Ndërmarrjeve Publike. Pse Njësia për monitorim të Ndërmarrjeve Publike nuk ka arritur të hartoj një raport të mirë të performancës së këtyre ndërmarrjeve, me elemente krahasuese të matshme, nëse sipas MZHE-së kjo performancë ekziston? Bazuar në atë që është thënë nga NJPMNP në këtë raport, ku NJPMNP ka lavdëruar Ndërmarrjet Publike, duke aluduar në atë se kanë një performancë të mirë, mirëpo bazuar në vizionin, objektivat dhe synimet financiare që kanë ndërmarrjet publike, që asnjëherë nuk po munden të realizojnë, lë të kuptohet se këtu kërkohet një angazhim me i madh dhe serioz i NJMNP, si dhe institucioneve të tjera përgjegjëse, duke ndikuar në përmirësimin e politikave adekuate për monitorim, llogaridhënie dhe transparencën. A mendoni se NJPMNP bashkë me MZHE-në, kanë kapacitete njerëzore të mjaftueshme, për monitorim me këto ndërmarrje.

Imri Ahmeti- Shqyrtimi i këtij Raporti po bëhet me vonesë dhe rekomandimet që do të dalin do të jenë të vonuara. Raporti nuk ka tregues të mjaftueshëm për performancën e Ndërmarrjeve Publike. Në raport mungojnë shumë të dhëna, dhe këtë ka dhënë edhe eksperti, edhe ZAP-i. Do të thotë raportit i mungojnë elementet për të pasur një gjykim të drejtë. Këto ndërmarrje menaxhojnë asete të rëndësishme dhe me vlerë për vendin tonë, si dhe menaxhojnë me resurse të mëdha humane. Prandaj, pesha që i është dashtë t'i jepet këtyre Ndërmarrjeve Publike nuk vërehet. P.sh. gjendja faktike në KEK nuk mund të përshkruhet me dy faqe raport! Nuk janë përmendur sfidat e këtyre ndërmarrjeve. Nuk ka një analizim të saktë se sa janë realizuar objektivat. Cilësia e shërbimeve nuk është dhënë se është ngritur. Komisioni nuk duhet ta përkrah këtë raport, sepse nuk plotëson kushtet kriteret për miratim.

Murselj Haljilji – Raporti duhet të përmbajë të dhëna për shërbimet e ofruara nga Ndërmarrjet Publike si: te furnizimi me ujë - a është kualitet uji? A kemi deponi të qytetit dhe a pastrohen me kohë? A ekziston kualiteti i sinjaleve? Pra, a po plotësohen nevojat e qytetarëve? Këto i mungojnë raportit. Mjetet e shpenzuar duhet të jenë të lidhura me kualitetin e shërbimit. Raporti ka të dhëna pozitive, sepse shihet se ka progres me zvogëlimin e shpenzimeve, pastaj ndërmarrjet kanë – pranuar rekomandimet dhe po punohet në këto. A keni informata se sa janë të kënaqur shfrytëzuesit e shërbimeve?

Adem Grabovci – Tha se të arriturat janë të prekshme -nuk po përballemi më me mungesë të energjisë elektrike-domethënë kemi arritur premtimin e dhënë për 24 orë energji elektrike. Normalisht kjo nuk është e mjaftueshme, dhe të gjithë duhet të angazhohemi më shumë për të

pasur suksese më të mëdha, sepse ne mund të jemi edhe furnizues, e jo vetëm importues të produktit. Pastaj, ndërmarrjet kanë operuar me një gjendje të rëndë, pastaj edhe ministri aktual ka trashëguar gjendjen e rëndë në këto ndërmarrje. Ndoshta duhet të kemi më shumë të dhëna, por Raporti ka të dhëna për të krijuar mendimin se ndryshimi pozitiv është evident. Opinioni duhet të njoftohet me situatën reale. Ndryshimet janë evidente dhe qytetari po i pranon ato. Kërkoj nga ministri sqarim nëse mbështetja financiare nga buxheti i shtetit është në rënie apo në ngritje? Borxhet e këqija- a janë në rritje, janë konstante apo ka përmirësim? Këto janë të dhëna për të cilat duhet të informohet opinioni.

Lars Lage Oloffson - Raporti për performancën e Ndërmarrjeve Publike nuk është i punuar nga ZAP- i. Ne kemi audituar 7 ose 9 nga ndërmarrjet publike, shumica prej tyre janë të nivelit qendror, pastaj është RTK-ja që është një shifër pak problematike, sa i përket ndërmarrjeve publike. Në këto auditive, të cilat kanë qenë më shumë auditime menaxheriale, kemi vërejtur një numër sfidash për këto ndërmarrje publike. Ne kemi hartuar raporte, kemi dhënë rekomandime si Menaxhmentit, Bordit të Drejtorëve si dhe të pronarit, në këtë rast është Ministria për Zhvillim Ekonomik. Nëse duam shërbime të mira për qytetarët, atëherë çështjet e niveleve të ndryshme duhet të trajtohen në mënyra të ndryshme. Gjithherë kur KMFP-ja kërkon që të japim pikëpamjen tonë për këtë raport apo raporte të ngjashme, ne me ligj jemi të obliguar të raportojmë. Të gjitha palët e interesit duhet të kenë një informacion më të mirë.

Ky raport është dashur të hartohet më herët, kur dihet se ky raport ka të bëjë me vitin 2011, ndërsa tani jemi në mars të vitit 2013, dhe se të dhënat në këtë raport tani mund të jenë ndryshe. Në raport mungojnë disa aspekte analitike për sa i përket informacionit formal. Këto organizata ekzistojnë për t'ju ofruar shërbime qytetarëve dhe debati politik që do të bëhet në parlament duhet të ketë fakte të mira mbi të cilat duhet të bazohet diskutimi dhe këto fakte duhet të përmbajë raporti.

Besim Beqaj, ministër - MZHE - Raporti që po diskutohet është Raport i performancës, e jo raport i auditimit dhe çdo koment në lidhje me paga, me gjëra të tjera, që kanë të bëjnë me raportin e auditorit duhet të bëhen në një takim të veçantë.

Eksperti i pavarur i angazhuar nga Komisioni është dokument të cilin në kushte normale nuk duhet të ndodhte, sepse i njëjti punon në Ministri të Financave dhe kjo për MZHE është konflikt interesi.

Raporti për Performancën e Ndërmarrjeve Publike është i bazuar në Raportin e Auditorit të Jashtëm, është i bazuar në raportet e zyrave të rregullatorëve dhe në Raportet Vjetore të Ndërmarrjeve Publike. Sektori i Energjisë ka shumë probleme. Kosova ka nevojë për 1300 MG energji, mirëpo nevojat për energji shumë më të mëdha, edhe pse prodhohet 100% e kapaciteteve ekzistuese, e që është e vërtetë se nuk mjafton. Këtu kemi rritje të inkasimit, zvogëlimin e humbjeve qoftë komerciale, po ashtu edhe ato teknike, ndërrimin e transformatorëve. Subvencionimi në këtë sektor ka rënë nga 40 milionë euro, sa ishin më herët, në vetëm 11 milionë euro, këtu kemi pra rritje të të hyrave vetanake të vetë KEK-ut. Këtu ankesat e bizneseve kanë rënë si rezultat i furnizimit të mjaftueshëm me energji elektrike për nevojat të bizneseve në veçanti. Vitin e kaluar kemi pasur një dimër shumë të vështirë dhe ne kemi arritur të mbajmë sistemet në funksion dhe të ofrojmë energji të mjaftueshme për qytetarët.

Sektori i Telekomunikacionit- ka pësuar reforma të nevojshme të cilat ishin të domosdoshme për funksionimin e përgjithshëm në sistemet e telekomunikimeve, telefonia fikse tani është gati e përdorshme.

Sektori i transportit- shihet se Aeroporti Ndërkombëtar ka rënie të fitimeve dhe kjo është për shkak të koncesionimit të ndodhur. Kjo nuk do të thotë se ka rënie të performancës së kësaj ndërmarrje. Sa i përket ndërmarrjeve të tjera Train-Kos dhe Infra-Kos, këtu kemi më tepër subvencionim të këtyre ndërmarrjeve, ngase deri vonë kjo ndërmarrje ka funksionuar si e vetme, mirëpo tani është ndarë dhe se fitimet e realizuara nga shitja e biletave, si dhe transporti humanitar është ende duke u subvencionuar nga Qeveria për Train –Kos. Mirëpo për vitin 2011 kishte me pak ndarje buxhetore.

Sektori i Ujërave – Tarifat e sektorit të ujit i cakton rregullatori i ujit dhe sa i përket cilësisë së Ujit duhet të i drejtoheni ZRRUM, e cila ka mandat për rregullimin e kësaj fushe. Dy kompani kanë rritur fitimet financiare dy kanë minimizuar humbjet, ndërsa 7 prej tyre janë në rrugë të mirë për tejkalimin e vështirësive financiare. Është e vërtetë se Ndërmarrja Ibër Lepenci- kemi rënie të nivelit të ujit për arsye të mungesës së reshjeve atmosferike dhe kjo nuk është varur nga menaxhmenti i kësaj kompanie.

Te ndërmarrjet e Hedhurinave, është një çështje që kërkon vëmendje, ngase qytetarët nuk po paguajnë faturat e shërbimeve, dhe po ashtu, Kuvendet Komunale që marrin fonde nga niveli qendror. Për këtë qëllim për pagesën e shërbimeve të ofruara nga këto ndërmarrje, nuk po bëjnë pagesat e duhura. MZHE ju ka bërë me dije secilës komunë se nëse nuk paguhen faturat për shërbimin e ofruar, në mënyrë automatike përmes Ministrisë së Financave, do t'ju paguajmë kompanive borxhet e papaguara nga buxheti i Kuvendeve Komunale. Përkrahja financiare nga qeveria- ndarja e mjeteve në kategorinë e subvencioneve për të gjitha ndërmarrjet publike për vitin 2011 ishte për 26.5% me e ulët dhe kjo është një input që tregon se këto ndërmarrje kanë performuar mirë.

Po ashtu projektet kapitale në këto ndërmarrje si: KEK, KOSTT, Tain –Kos, Infra-Kos ishin prej 12.3 milionë euro për vitin 2011, që tregon se fondet në shumicën e rasteve janë nga të hyrat vetanake.

ZAP nuk ka pasur të drejtë të japë opinionin e vet lidhur me performancën e ndërmarrjeve publike, për arsye se nuk është bërë auditimi i të gjitha ndërmarrjeve nga vetë ZAP-i.

Po ashtu MZHE ka ndaluar pagesat në komitete dhe këshilla të anëtarëve të bordeve, nëse kjo shume kalon 50% e rrogës bazë, si dhe rregulloret për udhëtime zyrtare dhe përdorimi i automjeteve të këtyre ndërmarrjeve nga anëtarët e bordeve.

Ne, po ashtu, kemi përgatitur planin e veprimit për kompanitë e ujit dhe i njëjti është dorëzuar në ZAP. Dhe jemi të bindur se mbi 90% e këtij plani të veprimit është përmbushur.

Sa përket kompanive të ujit dhe humbjeve të ujit, nuk janë fajtorë kompanitë e ujit që gypat e furnizimit me ujë nuk janë ndërruar që 30 vite, po ashtu nëse krahasohet Kosova me vendet e regjionit, ne jemi me mirë se sa vendet në regjion sa i përket humbjeve të ujit.

Nuk është e vërtetë që 4 ndërmarrje publike nuk i kanë fare bordet, ato mund të mos jenë funksionale, por bordet i kanë. Dhe po ju garantoj se gjendja në Ndërmarrjet Publike është me ndryshe. Qeveria ka nënshkruar për 2012 mbi 130 milionë euro kontrata afatshkurtra dhe afatgjata për shërbime për qytetarët, 22 milionë euro për Prizrenin, 12 milionë euro për Gjakovën për ujërat e zeza, 34 milionë euro Ujësjellësi në Prishtinë, etj.

Kryetari – Lidhur me angazhimin ekspertit, Komisioni e ka angazhuar dhe për të mbanë përgjegjësi. Arsyetimi se keni trashëguar një ligj të keq të hartuar nga Kuvendi, duhet t'ju kujtoj se hartues i ligjeve është Qeveria, Kuvendi miraton ato. Është e vërtetë se ka pasur ligje të këqija.

Ramiz Lladrovci – Komisioni shqyrton raportet e shkruara. Jemi të kënaqur me raportimin e ministrit në mbledhje, por këto informata nuk përmban raporti. Këtu lind edhe nevoja që ministri të jetë i pranishëm gjatë shqyrtimit të raporteve. Shpresoj që raporti i vitit 2012, do të plotësojë pritjet e Komisionit dhe propozoi që raporti në mbledhje plenare të rekomandohet për miratim, bashkë me informatat e ofruara nga ministri.

Adem Grabovci – Përgëzoi ministrin për përgjigjet e dhëna. Me këto informacione plotësohet raporti me të dhëna konkrete. Është normale që qytetari i Kosovës ka të drejtë të jetë i pakënaqur, sepse nevojat janë shumë më të madh se sa mundësia që kemi. Na takon neve që ta informojmë qytetarin në mënyrë reale. Pra, qytetari është parametri më i mirë matës se ka progres, sepse ka marrë shërbime më të mira.

Imri Ahmeti – Jemi të vetëdijshëm që po shqyrtojmë raportin për Ndërmarrjet Publike. Nga raporti nuk ka informata për të nxjerrë një konkludim se gjendja është e mirë. Përgjigjet e ministrit ishin vetëm për progres, por jo për sfida, keqpërdorim, nepotizëm etj. Energjia 24 - në

atë kohë keni pasur rekomandime që sistemi i faturimit ka të meta. Ky problem po përsëritet. Çka ka ndërmarrë Ministria që kjo të mos përsëritet?

Lage Oloffson - Në takimi i ditës së sotme është e vërtetë se nuk është diskutuar ndonjë raport i auditimit, mirëpo raporti i punuar nga NJMNP, është i bazuar në raportet e auditimit për Ndërmarrjet Publike, kështu që ZAP nuk publikon raporte të auditimit nëse nuk janë studiuar mirë dhe për këtë është pajtuar menaxhmenti i ndërmarrjes së Audituar, këtë e parasheh edhe korniza Ligjore mbi të cilën funksionon ZAP.

Kurdo që Komisioni kërkon pikëpamjet e ZAP-it me ligj duhet ta bëjmë këtë. Kjo është në pajtim me ligjin.

Kryetari – Përgjigjet e ministrit janë premtuese. Komisioni do ta marrë informacione lidhur me përmirësimin e gjendjes në raportin e radhës. Propozoi që Komisioni të kërkojë nga MZHE raport plotësues dhe një plan veprimi, në mënyrë që pastaj seancës t'i procedohet informacioni i plotësuar.

Bali Muharremaj – Tha se Komisioni do të marrë raportin 2012, dhe është e panevojshme që të kërkojë raport plotësues për vitin 2011. Komisioni mund të dalë me rekomandime shtesë, por jo për raport plotësues ose plan veprimi.

Ramiz Lladrovci - Propozoi që t'i rekomandohet seancës miratimi i Raportit.

Kryesuesi konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, lidhur me propozimin e deputetit Ramiz Lladrovci, me katër vota "për" dhe katër "kundër", në bazë të nenit 51 të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës, Kuvendit i

Rekomandon

- 1. Të mos miratohet Raporti për Performancën e Ndërmarrjeve Publike, për vitin 2011.**
- 2. Arsyetimin e Rekomandimit e paraqet, deputeti Ali Sadriu, kryetar i Komisionit.**

4. Të ndryshme

Bali Muharremaj – Njoftoi anëtarët e Komisionit, lidhur me anulimin e tenderit për përzgjedhjen e auditorit të jashtëm, i cili do të bëjë auditimin e pasqyrave vjetore financiare të ZAP-it për vitin 2012. Anulimi është rekomanduar nga Komisioni vlerësues, për shkak se nga katër ofertuesit, vetëm një ka qenë i përgjegjshëm.

Mbledhja përfundoi në orën 14:30.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit

Ali Sadriu